

Drejtuar: **Shoqërisë "Illyrian Guard" sha**

Rruga "Ibrahim Rugova", ish-Garda e Republikës (ish Reparti 448), Tiranë

Lënda: Mbi shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve dhe shoqërimin e vlerave monetare.

1. "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për personat dhe personelin e OSSH sh.a. Drejtoria Rajonale Elbasan"

Në bazë të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në mënyrë periodike, kemi proceduar me realizimin e procedurave të prokurimit, për përfitim nga operator ekonomik të licensuar të "Shërbimit të ruajtjes dhe sigurimit fizike dhe në distancë" të objekteve që kemi në pronësi e administrim.

Në kushtet kur kontrata aktuale është drejt përfundimit, në bazë të nenit 10 të VKM nr.177, datë 04.04.2019, ju drejtohem për të përfituar shërbimin me objekt "*Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSSH Sh.a. dhe FSHU Sh.a. në Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin*".

Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të përcaktuara kërkohet të realizohet me punonjës shërbimi në çdo vendroje si dhe nëpërmjet vendosjes së sistemeve të alarmit dhe kamerave të vëzhgimit, duke verifikuar me grup të gatshëm çdo sinjal alarmi apo situatë emergjente që do të konstatohet.

Shërbimi kërkohet të kryhet në 17 (shtatëmbëdhjetë) vendroje. Në këto vendroje shërbimi do të kryhet i kombinuar, shërbim me roje fikse 24 orë, 12 orë (turni I+II) dhe 8 orë (turni I), dhe shërbim me sisteme alarmi dhe sisteme vëzhgimi, sipas tabelës së mëposhtme. Fondi i miratuar dhe vënë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, për një periudhë 12 muajore, i cili përfshin shërbimin me roje fikse dhe sisteme alarmi dhe vëzhgimi/kamera, është **49,451,086** (dyzetë e nëntëmilion e katërqind e pesëdhjetë e njëmijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh.

Në tabelën e mëposhtme është informacioni për vendrojet ku do të kryhet shërbimi :

Nr.	Emërtimi i Objektit ku do të kryhet shërbimi	Nr. Vendroje	Orët e shërbimit me roje fikse	Nr. i rojeve në çdo vendroje	Sistem alarmi	Sistem vëzhgimi
Objekte të OSSH						
1	Librazhd Zyra	1	8	1.43	Sistem alarmi	4 (kater)kamera vëzhgimi
2	Elbasan magazina	2	24	4.98	Sistem alarmi	4 (kater)kamera vëzhgimi
3	Elbasan zyra Zona	1	24	4.98	Sistem alarmi	6 (gjashte) kamera vëzhgimi
4	Elbasan TL Zyra	1	24	4.98	Sistem alarmi	4 (kater)kamera vëzhgimi
5	Elbasan N/S (1)	1	24	4.98	Sistem alarmi	4 (katër) kamera vëzhgimi
6	Elbasan N/S (2)	1	24	4.98	Sistem alarmi	4 (katër) kamera vëzhgimi
7	Gramsh Zyra	1	8	1.43	Sistem alarmi	3 (tre) kamera vëzhgimi
8	Peqin Zyra	1	8	1.43	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi
9	Cërrik Zyra	1	12	2.14	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi
Objekte të FSHU						
1	Librazhd KNK	1	12	2.14	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi
2	Elbasan KNK	1	12	2.14	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi
3	Elbasan KNK 2	1	12	2.14	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi
4	Gramsh KNK	1	12	2.14	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi
5	Peqin KNK	1	8	1.43	Sistem alarmi	2 (dy)kamera vëzhgimi
6	Përrenjas KNK	1	8	1.43	Sistem alarmi	2 (dy)kamera vëzhgimi
7	Cërrik KNK	1	8	1.43	Sistem alarmi	2 (dy)kamera vëzhgimi
8	Belsh arka	1	8	1.43	Sistem alarmi	3 (tre)kamera vëzhgimi

Sa më sipër shprehim gatishmërinë që të kryeni çdo verifikim apo kontroll të objekteve sipas tabelës së mësipërme.

OSSH Sh.a

Lagja 28 Nentori, Rruga Kadri Abdihoxha, Elbasan , Shqipëri
e-mail:, www..... | NIPT: L81530018E

2. "Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësine e Koordinimit Elbasan FSHU sh.a."

Gjithashtu autoriteti kontraktor OSSH-sh.a. Drejtoria Rajonale Elbasan ka në plan të zhvillojë dhe procedurë me objekt "Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësine e Koordinimit Elbasan FSHU sh.a. . Fondi i planifikuar për një periudhë 1 vjecare është 9.184.750 (nente milion e njeqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë lekë pa TVSH. Shërbimi i kërkuar do të jetë si me poshte.

TERMAT E REFERENCËS

- Shoqërimi i sigurtë i punonjesve (arketareve) nga filialet e OSHEE sh.a drejt filialeve të bankave respektive sipas zgjedhjes së OSHEE sh.a.
- Punonjësi i OSHEE sh.a (arketari/rja) duhet të shoqërohet nga 2(dy) roje të armatosur.
- Rojat duhet të jenë të pajisura me armatim sipas ligjeve në fuqi.
- Shoqërimi duhet të kryhet nga një mjet i kompanisë së shoqërimit, mjeti duhet të jetë i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare të kryeje shoqërimin e vlerave monetare.
- Koha maksimale e procesit të shoqërimit të vlerave monetare do të jetë 2(dy) orë. Koha orare e shoqërimit të vlerave monetare do të jetë :
 - Turni i parë nga ora 15:00-17:00
 - Turni i dytë nga ora 20:00-22:00
- Shërbimi i shoqërimit të vlerave monetare do të kryhet me 5 Grupe Shoqërimi (Eskorta). Grupet e Shoqërimit do të paraqiten pranë KNK/Arke (sipas Grafikut të mëposhtem) në orën 15^{oo} gjatë Turni I dhe 20^{oo} Turni II. Kohëzgjatja e Shërbimit përfshinë :
 1. paraqitjen e Grupeve të Shoqërimit në orarin e percaktuar,
 2. pritja e përfundimit nga arkëtarët e procesit përpunimit të veprimeve të arkës,
 3. shoqërimi i arkëtareve nga KNK deri në mjetin e blinduar,
 4. shoqërimi i vlerave monetare nga KNK/Arka me destinacion Degët e Bankës së nivelit të dytë,
 5. shoqërimi i arkëtareve nga mjeti i blinduar në degën e Bankës ë nivelit ë dyte dhe deri në përfundimin e procesit të depozitimit të vlerave monetare nga arkëtarët në Bankë.
 6. Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformën dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas legjislacionit në fuqi.

Grafiku i shërbimit

Nr	Emertimi i KNK-ve	Turni i pare	Turni i dyte
1	KNK Nr.1; Qyteti Elbasan	po	po
2	KNK Nr.2; Qyteti Elbasan	po	po
3	KNK; Qyteti Librazhd	po	po
4	KNK; Qyteti Prrenjas	po	jo
5	KNK; Qyteti Gramsh	po	po
6	KNK; Qyteti Cerrik	po	jo
7	KNK; Qyteti Peqin	po	jo
8	Belsh arka	po	jo

OSSH Sh.a

Lagja 28 Nentori, Rruga Kadri Abdihoxha, Elbasan , Shqiperi
e-mail: , www..... | NIPT: L81530018E


Kërkojmë nga ana juaj të na konfirmoni si Autoritet Kontraktor në se shprehni gadishmërinë tuaj për të proceduar me lidhjen e kontratës për këto shërbime me kushtet e sipërpermendura.

Me konsideratë

Irland SINA

Drejtori
Drejtoria Rajonale Elbasan

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A



OSSH Sh.a

Lagja 28 Nentori, Rruga Kadri Abdihoxha, Elbasan , Shqiperi
e-mail: , www..... | NIPT: L81530018E